

**URDHËR**  
**Nr. 159, datë 11.3.2020**

**PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES SË PACIENTËVE, SHOQËRUESVE DHE/OSE  
FAMILJARËVE DHE ORGANIZIMIN E SHËRBIMEVE NË INSTITUCIONET E  
KUJDESIT SHËNDETËSOR KU KRYHEN VIZITA DHE KONSULTA  
AMBULATORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe të udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

**URDHËROJ:**

1. Në ambientet e brendshme apo strukturat e veçanta të institucioneve të kujdesit shëndetësor, poliklinika e spitale, të sistemit publik dhe jopublik, ku zhvillohen vizita dhe konsulta ambulatore të merren masa të menjëhershme për ndalimin e grumbullimit të pacientëve dhe organizimin e shërbimit ambulator duke ruajtur perimetrin e sigurisë për parandalimin e përhapjes së COVID-19. Distanca midis pacientëve dhe ofruesve të shërbimit, duhet të jetë jo më pak se 1.5 metër distancë nga njëri-tjetri.

2. Të ndalohet prezenca e familjarëve apo të afërmeve në mjediset e konsultave, poliklinikave, qendrave shëndetësore me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19.

3. Institucionet e kujdesit shëndetësor ku kryhen vizita ambulatore të marrin masa për respektimin e kërkesave të pikës 1 dhe 2 të këtij urdhri.

4. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor organizon punën në institucionet e kujdesit shëndetësor, qendrat shëndetësore, poliklinikat dhe spitalet për të siguruar bazën e shërbimeve të nevojshme bazë për qytetarët duke nxitur përdorimin e shërbimeve *online* dhe platformave *e-Albania* dhe Telemjekësia.

5. Fondi i Sigurimit të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor të marrë masa për nxjerrjen e udhëzimeve për lehtësimin e procedurave dhe përdorimin e sistemeve elektronike në paketën e barnave të rimbursueshme duke krijuar dhe promovuar shërbimet *online*.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, FSDKSH-ja, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, strukturat shëndetësore të kujdesit shëndetësor, si dhe të gjithë spitalet publike dhe private.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
**Ogerta Manastirliu**